

28 shtator 2013, Prizren

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Komuna e Mamushës të zbatoj rekomandimet e Auditorit të Përgjithshëm

Në kuadër të projektit të monitorimit të punës së ekzekutivit komunal të Mamushës, EC Ma Ndryshe gjatë muajit shtator ka shqyrtuar çështjen e të gjeturave në Raportin e Auditimit të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm (mund të gjendet në linkun: http://www.oag-rks.org/repository/docs/MAMUSHE_Report_ALB_660338.pdf) mbi pasqyrat financiare të komunës së Mamushës për vitin 2012.

Ky Raport i Auditimit ka identifikuar dobësi në disa fusha të menaxhimit financiar, që duhet të adresohen nga Komuna e Mamushës. Përfundimi i ZAP-it është se sistemi i kontrolleve të brendshme të Komunës nuk është përcaktuar dhe nuk është zbatuar siç duhet për të eliminuar dobësitë e dukshme.

Sa i përket të hyrave vetanake të Komunës së Mamushës ZAP ka gjetur mangësi në sistemin e faturimit, mbledhjen e të hyrave vetanake dhe dobësi në sistemin e automatizuar të faturimit.

Ndërsa te shpenzimet sfiduese mbetet çështja e prokurimit. Sipas ZAP-it shpenzimet për prokurimet nr. 626 12 017 236, 626 12 018 236 dhe 626 12 003 236, janë paraqitur si shpenzime kapitale, në vend të paraqitjes si shpenzime për mallra dhe shërbime, respektivisht sipas natyrës. “Nëse këto shpenzime do të kategorizoheshin në kategorinë e saktë, buxheti për mallrat dhe shpenzimet do të ishte tejkaluar për 11 mijë Euro”, thuhet në Raportin e Auditimit.

Te subvencionet dhe transferimet ZAP ka gjetur se Komuna nuk ka politika të shkruara mbi subvencionet, që do të përmbanin kritere dhe procedurat për lejimin e subvencionit, derisa defekte ka pasur edhe te kategoria e Pasurive.

Si shqetësim tjetër që figuron në Raportin e ZAP-it është fakti se nga 11 rekomandime kryesore të paraqitura një vit më parë, vetëm një është zgjidhur dhe tre janë zgjidhur pjesërisht gjatë vitit 2012, derisa të tjerat mbeten për t’u adresuar.

Në anën tjetër, me qëllim që të përmirësohet funksionimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe i kontrolleve të brendshme, ZAP ka rekomanduar komunën e Mamushës që të sigurojë:

- Një listë të plotë të pronave, ndërtesave dhe pajisjeve të Komunës;
- Vendosjen e një sistemi automatik të faturimit për të gjitha llojet e taksave;
- Marrjen e masave për të rritur mbledhjen e të hyrave nga taksat e ndryshme; dhe
- Pajtueshmëri të plotë me Ligjin Nr. 04/L-042, “Ligji për Prokurimin Publik në Kosovë”.

Në raport ceket se menaxhmenti të Komunës i është ofruar mundësia të japin komentet për gjetjet tona të prezantuara në këtë raport dhe se menaxhmenti ka rënë dakord të bëjë të gjitha përpjekjet për t’i adresuar të gjitha rekomandimet e ZAP-it.

Bazuar në të gjeturat dhe konstatimet e ZAP-it, EC Ma Ndryshe rekomandon komunën e Mamushës që të:

- Tregoj përkushtim në zbatimin e 9 rekomandimeve të paraqitura nga ZAP-i në raportin e fundit dhe rekomandimet e viteve të kaluara;
- Të krijoj një Komitet Auditimi dhe Departamentin e Auditimit të Brendshëm;
- Të përmirësoj standardet e qeverisjes së parasë publike dhe
- Lejoj kuvendarët e KK-së që të ushtrjnë kontroll dhe mbikëqyrje të shpenzimit të buxhetit komunal.

Projekti i EC Ma Ndryshe për monitorimin e transparencës së ekzekutivit do të vazhdojë të publikojë të gjeturat e monitorimit përmes komunikatave të rregullta dhe përmes ueb-faqes së projektit, ku të gjeturat postohen drejtpërdrejtë nga monitoruesit. Tanimë të gjitha të gjeturat e monitorimit, përfshi komunikatat e rregullta dhe shumë informacione të tjera në lidhje me qeveritë lokale të Prizrenit dhe të Mamushës publikohen në baza të rregullta në ueb-faqen e projektit, www.online-transparency.org.

Ju faleminderit për bashkëpunimin tuaj,

Elmedina Baxhaku, Monitoruese
OJQ EC Ma Ndryshe
Rr. Saraçët, Nr. 5 - Prizren
Rr. Zeki Shulemaja, Nr. 2 - Prishtinë
www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org
+381 38 224 967 & +381 29 222 771



British Embassy
Pristina

Projekti "Transparenca online e komunës së Prizrenit dhe Mamushës" prej muajit maj 2013 përkrahet financiarisht nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë.